

Lotaria Kombëtare sh.p.k.

Pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017:

Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirë.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime për pasqyrat financiare	5 – 24



KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri
+355 (4) 2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Aksionarin e Lotaria Kombëtare sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Lotaria Kombëtare sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse

ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Heris Jahi
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 26 prill 2018

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e pozicionit financiar

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktive			
Aktive afatgjata të trupëzuara	6	169,581,936	217,661,950
Aktive afatgjata të patrupëzuara	7	270,398,874	321,983,074
Totali i aktiveve afatgjata		439,980,810	539,645,024
Tatim fitimi i parapaguar		40,000	40,000
Inventarët	8	52,025,418	72,006,761
Kërkesa të arkëtueshme	9	24,657,546	20,770,527
Aktive të tjera	10	26,303,360	14,899,089
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	11	131,630,653	11,733,119
Totali i aktiveve afatshkurtra		234,656,977	119,449,496
Totali i aktiveve		674,637,787	659,094,520
Kapitali			
Kapitali aksionar	12	2,570,940,000	1,201,950,000
Humbjet e mbartura		(2,020,442,058)	(1,663,871,276)
Totali i kapitalit		550,497,942	(461,921,276)
Detyrimet			
Kredi dhe hua afatgjata	13	-	998,257,970
Detyrime tatimore të shtyra	25	11,620,850	11,256,968
Totali i detyrimeve afatgjata		11,620,850	1,009,514,938
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	13	341,956	7,651
Të pagueshme ndaj furnitorëve	14	15,041,477	13,521,094
Detyrime të tjera	15	37,773,017	49,221,697
Detyrimet e lojrave	16	59,362,545	48,750,416
Detyrime afatshkurtra		112,518,995	111,500,858
Totali i detyrimeve		124,139,845	1,121,015,796
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		674,637,787	659,094,520

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri në 24.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor	
		2017	2016
Të ardhura nga lotaritë	17	249,349,055	272,067,105
Të ardhura të tjera		39,187,387	28,493,922
Totali i të ardhurave		288,536,442	300,561,027
Shpenzime marketingu	18	(98,130,191)	(43,006,922)
Shpenzime për çmimet e lotarisë	19	(142,184,091)	(157,576,226)
Shpenzime personeli	20	(110,252,109)	(89,141,146)
Tarifat dhe taksat mbi lojërat e fatit	21	(32,266,889)	(35,325,855)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(100,114,049)	(107,831,911)
Komisione për agjentët	22	(24,128,829)	(27,617,178)
Shpenzime për materialet	23	(10,964,783)	(8,775,098)
Shpenzime të tjera operative	24	(101,674,397)	(57,901,322)
Rezultati nga veprimtaria operative		(331,178,896)	(226,614,631)
Shpenzime financiare	25	(25,039,769)	(51,726,808)
Të ardhura financiare	25	11,765	14,482,274
Shpenzime financiare, neto		(25,028,004)	(37,244,534)
Humbja para tatim-fitimit		(356,206,900)	(263,859,165)
Shpenzim nga tatimi i shtyrë	26	(363,882)	(3,634,228)
Humbja për periudhën		(356,570,782)	(267,493,393)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën		(356,570,782)	(267,493,393)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri në 24.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Humbjet e mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	1,201,950,000	(1,396,377,883)	(194,427,883)
<i>Totali humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën</i>			
Humbja për periudhën	-	(267,493,393)	(267,493,393)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të periudhës	-	(267,493,393)	(267,493,393)
Transaksionet me pronarët e Shoqërisë, të njohura direkt në kapital	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,201,950,000	(1,663,871,276)	(461,921,276)
<i>Totali humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën</i>			
Humbja për periudhën	-	(356,570,782)	(356,570,782)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të periudhës	-	(356,570,782)	(356,570,782)
Transaksionet me pronarët e Shoqërisë, të njohura direkt në kapital	1,368,990,000	-	1,368,990,000
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,570,940,000	(2,020,442,058)	550,497,942

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, në faqet 5 deri në 24.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Lotaria Kombëtare sh.p.k më 25 prill 2018 dhe nënshkruar si me poshtë:



 Peter Simoner Paul Pialek
 Administrator Administrator



 Dritan Basha
 Drejtor i Financës

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e flukseve monetare

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	2017	2016
Flukse monetare nga aktiviteti operativ		
Humbja para tatim fitimit	(356,206,900)	(263,859,165)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin	6 48,529,849	51,281,869
Amortizimin	7 51,584,200	56,550,042
Zhvlerësimin e inventarit	21,601,178	-
Vlera kontabël neto e aktiveve të shitura	23 2,650,720	38,453
Shpenzime financiare	24 4,359,047	51,726,808
Të ardhura nga interesat dhe të tjera financiare	24 (11,765)	(12,556)
	(227,493,671)	(104,274,549)
<i>Ndryshimet në:</i>		
Inventarë	8 (1,619,835)	2,153,751
Kërkesa të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9 (3,887,019)	10,573,379
Aktivet e tjera	10 (11,404,271)	(7,922,599)
Furnitorë	14 1,520,383	2,315,521
Detyrimet e tjera	15 (836,551)	5,859,953
	(243,720,964)	(91,294,544)
Interesa dhe të ardhura të tjera financiare	24 11,765	12,556
Flukse monetare neto nga aktiviteti operativ	(243,709,199)	(91,281,988)
Flukse monetare nga aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	6 (3,888,772)	(168,000)
Të hyra nga shitja e aktiveve të qëndrueshme	788,217	-
Flukse monetare neto të përdorura në aktivitetin investues	(3,100,555)	(168,000)
Flukse monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		
Të hyra nga kapitali i ri i emetuar	1,368,990,000	-
Shuma të marra nga huatë e reja	13 334,305	129,010,902
Ripagimi i huave	(998,257,970)	-
Interesi i paguar	24 (4,359,047)	(51,726,808)
Flukse monetare neto nga aktiviteti financues	366,707,288	77,284,094
Rritja neto /(Pakësimi) në mjete monetare dhe ekuivalente me to	119,897,534	(14,165,894)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	11 11,733,119	25,899,013
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës	11 131,630,653	11,733,119

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri në 24.

1. Informacion i përgjithshëm

Lotaria Kombëtare sh.p.k (“Shoqëria”), e quajtur me parë OLG Project sh.p.k u krijua në Shqipëri si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 19 shtator 2012. Adresa e saj është “Rruga Murat Toptani, Qendra e Biznesit Eurocol, Kati 6, Tiranë”, dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numër unik identifikimi L22119005R, si filial në pronësi të plotë të Albanisch Österreichische Lotterien Holding Gesellschaft (“Shoqëria mëmë” - direkte), e cila është një shoqëri ‘holding’ me vendndodhje në Gumpoldskirchen, Austri, dhe adresë biznesi në Wiener Straße 158, 2352 Gumpoldskirchen, Austri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës Tregtare të Vienës nën FN 383662 I, e cila fitoi tenderin për administrimin ekskluziv të Lotarisë Kombëtare në Shqipëri, sipas licencës së dhënë nga Qeveria e Shqipërisë më 19 dhjetor 2012, lëshuar nga Ministria e Financës për një periudhë prej 10 vitesh.

Aktiviteti i regjistruar i Shoqërisë është në veprimtarinë e industrisë së lojërave të fatit. Shoqëria i ka paguar një tarifë për licencën prej 500,000,000 Lek Ministrisë së Financave të Shqipërisë më 15 tetor 2012. Shoqëria administrohet nga Z. Peter Simoner dhe Z. Paul Pialek, administratorët e Shoqërisë.

Marrëveshja e licencës u ratifikua nga Parlamenti dhe ka hyrë në fuqi më 4 mars 2013, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare, ndërmjet Ministrisë së Financës, si autoritet i autorizuar dhe ‘Oesterreichische Lotterien GmbH’, përfaqësuar nga ‘OLG Project’ sh.p.k’.

Gjatë vitit 2016, 100% të aksioneve të Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H. u blenë nga Novomatic Gaming Industries GmbH. Si rezultat, pala e re kontrolluese e Shoqërisë është Novomatic Gaming Industries GmbH. Bazuar në marrëveshjen e shitjes-blerjes së aksioneve, më datë 3 maj 2016, ndërmjet Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H (“shitësi”) dhe Novomatic Gaming Industries GmbH (“blerësi”), palët ranë dakord të transferonin kontrollin indirekt të Shoqërisë. Kjo u vlerësua si e plotësuar në 30 nëntor 2016, me përmbushjen e kushteve të mbylljes siç është përcaktuar në këtë marrëveshje, në përputhje me aprovimet e kërkuara nga autoritetet përkatëse në Shqipëri si një parakusht për transferimin e pronësisë.

Novomatic Gaming Industries GmbH është një filial i Novomatic AG, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit austriak me zyrën e regjistruar në Gumpoldskirchen, Austri. Grupi Novomatic (“Grupi”) është një grup që operon globalisht me një teknologji të integruar të lojërave të fatit dhe zbatimit, me më shumë se 35 vjet eksperiencë si prodhues i pajisjeve të reja të lojërave inovatore të teknologjisë së lartë. Shoqëria përfundimtare mëmë e Novomatic AG është Novo Invest GmbH, një shoqëri e regjistruar në Wiener Neustadt.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare bashkëngjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të cilat janë baza për raportimin financiar ligjor të Shoqërisë.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Vlerësimi i drejtimit lidhur me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar mbi parimin e vijimësisë

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka akumuluar humbje prej 2,020,442,058 Lek (2016: 1,663,871,276 Lek) dhe raportin kapital prej 550,497,940 Lek (2016: kapital negativ prej 461,921,276 Lek). Një pjesë e konsiderueshme e kësaj humbje i atribuohet fazës fillestare, që përfshin investime dhe shpenzime mjaft të larta në marketing, zhvillimeve të tregut dhe performancës së pakënaqshme të produkteve gjatë viteve të para të aktivitetit.

Për të përmbushur nevojat për kapital dhe likuiditet dhe për të vazhduar aktivitetin, Shoqëria Mëmë i ofroi mbështetje financiare Shoqërisë. Në vijim të ndryshimit të pronësisë të përshkruar në shënimin 1, në vitin 2017, kapitali i paguar u rrit me 1,235,610,000 Lek dhe huatë nga bankat u ripaguan plotësisht. Në dhjetor të vitit 2017, ka ndodhur një injektim tjetër i kapitalit në shumën prej 133,380,000 Lek.

Në vijim të ndryshimit të pronësisë, Shoqëria pret të ndryshojë dhe rishikojë strategjinë e biznesit dhe strukturën operacionale, duke e përshtatur atë me më shumë me nevojat e tregut lokal dhe duke optimizuar portofolin e produkteve. Shoqëria Mëmë nuk ka për qëllim likuidimin apo mbylljen e aktivitetit në një të ardhme të afërt dhe Mëma do vazhdojë ta mbështesë aktivitetin në Shqipëri financiarisht. Drejtimi beson se Shoqëria do jetë në gjendje të gjenerojë të ardhura brenda vitit 2019 dhe aftësia e saj për të vazhduar mbi parimin e vijimësisë nuk do të rrezikohet. Për këtë arsye, Shoqëria i ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi parimin e vijimësisë.

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(d) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të ndikuar. Në mënyrë të veçantë, informacioni rreth fushave të rëndësishme të vlerësimeve të pasigurta dhe të gjykimeve kritike në zbatimin e IFRS-ve, të cilat kanë ndikimin më të madh në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4.

3. Politika kontabël të rëndësishme

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit.

Në rastet kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (përbërësit më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit e një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e kontabël dhe njihen në vlerë neto në të ardhura të tjera/humbje të tjera operative dhe përfshihen në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme ndaj aktiveve afatgjata materiale njihen si në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi pasqyrohet në fitim ose humbje bazuar në metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve afatgjata materiale nga data kur ato janë gati për përdorim.

Jetëgjatësitë e parashikuara janë si më poshtë:

Pajisje TI	3-8 vite
Pajisje të lojërave të fatit	10 vite
Makina	5 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Të tjera	5 vite

Aktivitetet e marra me qira dhe përmirësimi i ambienteve të marra me qira amortizohen mbi jetëgjatësinë më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme, përveç rasteve kur është e sigurt se Shoqëria do të marre në pronësi aktivin në fund të afatit të qirasë. Në këto raste amortizimi llogaritet mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktivitetit.

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe përshtaten nëse është e nevojshme.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(b) Aktivët afatgjata jo-materiale

Aktivët afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka). Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve afatgjata jo materiale nga data në të cilën ato janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatësia e parashikuar e përdorimit është si më poshtë:

Programe Kompjuterike	4 vite
Licensa	10 vite

(c) Inventarët

Inventarët janë matur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin ("FIFO") për biletat gërvishtëse, ndërsa për pjesën e mbetur të inventarit, përdoret parimi i koston mesatare të ponderuar dhe përfshin koston e blerjes, koston e shndërrimit dhe gjithë koston e tjera për të sjellë inventarët në vendndodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus koston e vlerësuar të përfundimit të shitjes.

(d) Aktivët e marra me qira

Qiratë, për të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë i mbeten qiradhënësit, klasifikohen si qira operative. Pagesat e kryera mbi bazën e qirasë operative (neto nga çdo zbritje e marrë nga qiradhënësi) njihen në fitim ose humbje mbi baza lineare përgjatë periudhës së qirasë.

(e) Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative.

(i) Aktive financiare jo-derivative

Shoqëria fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivët e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron aktivët financiare nëse të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivët financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivët dhe detyrimet financiare netohen së bashku dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për ti kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose shlyerjen me vlerë neto, ose të realizojë shitjen e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

(ii) Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet monetare në arkë, depozita afatshkurtra bankare, të tjera investime afatshkurtër me likuiditet të lartë me maturitet fillestar deri në tre muaj ose më pak, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, dhe Shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

(iii) Kërkesa të arkëtueshme

Kërkesat e arkëtueshme janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, llogaritë e arkëtueshme e të tjera të arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi (shih shënimin 3)(f)(i)).

(iv) Detyrime financiare jo-derivative

Shoqëria i njihet fillimisht detyrimet financiare, në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë në depozitat kontraktuale të instrumentit. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(e) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Detyrime financiare jo-derivative (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi bazën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Shoqëria ka këto detyrime financiare jo-derivative: huatë, detyrimet të tjera dhe te pagueshme ndaj furnitorëve.

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus çdo kosto të drejtpërdrejtë të transaksionit. Pas njohjes fillestare, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare është diskutuar në politikën kontabël 3(n).

(v) Kapitali aksionar

Kapitali i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktivitet financiare

Një aktiv financiar jo i mbajtur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese, për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë ndikim negativ në flukset e ardhshme të parashikuara të atij aktivi dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivitet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqërisë me kushte që Shoqëria nuk do t'i merrte në konsideratë në rast të tjera, ose tregues që një klient do të shpallë falimentim.

Humbja nga zhvlerësimi i aktiveve financiare me kosto të amortizuar, matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të skontuar me normën fillestare efektive. Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në baza individuale. Aktivitet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe të cilat kanë karakteristika të njëjta të rrezikut të kreditimit.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), nëse kthimi ka lidhje objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me koston e amortizimit, kthimi njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktive jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimorë të shtyrë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitet. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitet ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (NJGJMM) tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e aktivitet ose NJGJMM është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të aktivitet ose NJGJMM. Për testimin e zhvlerësimit, aktivitet grupohen së bashku në grupet më të vogla të aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose NJGJMM.

Humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), deri në nivelin kur vlera kontabël e aktivitet nuk tejkalon vlerën kontabël që duhet të kishte patur aktivitet duke zbritur amortizimin, nëse humbja nga zhvlerësimi nuk do ishte njohur ndonjëherë.

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(g) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen fillimisht me vlerën e drejtë të shumës së arkëtueshme neto nga skontot dhe zbritjet.

Të ardhurat nga biletat e shitura tek konsumatorët për lojërat e fatit, për të cilat rezultati përcaktohet bazuar në një short njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në momentin që shorti hidhet. Kur lojtarët luajnë një shumë në avancë, kjo e ardhur shtyhet dhe njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse atëherë kur shorti përkatës realizohet.

Të ardhurat nga biletat gërvishtëse njihen kur janë bërë të disponueshme për shitje tek publiku, moment në të cilin bëhet aktivizimi i biletave në sistem.

Të ardhurat nga interesi njihen në bazë të përlllogaritjes kur fitohen dhe raportohen në periudhën financiare me të cilën lidhet.

(h) Fondet për çmimet e lotarisë

Lojrat me bazë shorti “Loto 6 nga 39” dhe “Keno” janë organizuar në bazë të një mekanizmi çmimesh sipas të cilit një përqindje e paracaktuar nga biletat e shitura alokohet për fondin e çmimeve. Në masën që çmimet e fituara prej shorteve në “Loto 6 nga 39” dhe “Keno”, ndryshojnë nga përqindja e paracaktuar e çmimeve, çmimet përkatëse mbarten në fondin për çmimet e ardhshme. Detyrimi për çmimet njihet në momentin e realizimit të shortit në përputhje me përqindjet e paracaktuara.

Fondet e çmimeve të Loto 6 nga 39” dhe “Keno” njihen bazuar në fitimet reale që rezultojnë në fund të çdo shorti.

Çmimet për biletat gërvishtëse njihen si përqindje ndaj shitjeve në përputhje me piramidën teorike të pagesave për çmimet.

Çmimet e fituara por të pa tërhequra në lojën kombëtare” Loto 6 nga 39” për më shumë se 90 ditë, rikthehen në lojë nëpërmjet “jackpot-eve” të garantuara dhe çmimeve promovuese në përputhje me rregullat e lojërave të fatit të aprovuara nga autoriteti rregullator.

(i) Komisionet dhe bonuset

Komisionet dhe bonuset e njohura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfaqësojnë komisione të cilat shkaktohen si pasojë: (i) e normave fikse mbi shitjet e bëra prej rishitësve dhe; (ii) shpërblime dhe bonuset të tjera të lidhura me shitjet. Kur një komision i paguhet një agjenti për shitjen e biletave të cilat i përkasin shorteve të ardhshëm, kjo shumë regjistrohet si shpenzim i parapaguar derisa e ardhura përkatëse të njihet.

(j) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Zbritjet e marrë për qiranë njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së saj.

(k) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

(l) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitime në trajta pensioni për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributësh pensioni. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(ii) Pagesat për lejet vjetore

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës së mbyllur.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(m) Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyre të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një fluks dalës të përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare.

(n) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet e investuara në banka dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Te ardhurat nga interesat njihen kur përfitohen, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi, komisione bankare dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi të faktit nëse lëvizjet në kursin e këmbimit rezultojnë në një pozicion neto fitimi apo humbje.

(o) Tatimi mbi lojërat e fatit

Bazuar në marrëveshjen e licencës me Qeverinë e Shqipërisë, Shoqëria është e detyruar të paguajë detyrime tatimore bazuar mbi totalin e qarkullimit bruto si me poshtë:

- Tatim mbi lojërat e fatit prej 10%;
- Tarifë kontributi për çështjet e mira prej 2.2%;
- Tarifë administrimi për njësinë e mbikëqyrjes së lojërave të fatit në masën 0.5%, por jo më pak se 2,000,000 Lek në vit.

(p) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose që do të miratohen në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Drejtimi vlerëson periodikisht pozicionin e marrë në deklaratat e raportuara tatimore presa i përket situatave në të cilat rregullorja e aplikueshme tatimore përbën subjekt interpretimi. Aty ku është e përshtatshme, drejtimi përcakton provizionim bazuar në shumat e pritshme për t'u paguar autoriteteve tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi ose që pritet të hyjë në fuqi deri në datën e raportimit.

Aktivitet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet dhe aktivitet aktuale, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme në masën që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Shoqëria njeh një aktiv tatimor të shtyrë mbi humbjet tatimore të mbartura në masën që është e mundur që këto humbje mund të përdoren kundrejt një fitimi të tatueshëm të ardhshëm.

(q) Transaksionet dhe balancat në valutë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në fuqi në datat e transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit, në atë datë. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten në termat e kostos historike përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në 'Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto'.

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(r) Standarde dhe interpretime të reja që nuk janë ende efektive

Disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet e interpretimit ekzistuese nuk janë ende të detyrueshme për zbatim për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2017, dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon t'i zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 15 Të Ardhura nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Standardi i ri zëvendëson udhëzimet ekzistuese për njohjen e të ardhurave sipas SNRF, duke përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet e Besnikërisë së Klientit. Shoqëritë do të zbatojnë një model me pesë hapa për të përcaktuar kur duhet njohur e ardhura dhe në çfarë shume. Modeli i ri saktëson që e ardhura duhet të njihet kur (ose ndërkohë që) një njësi ekonomike transferon kontrollin mbi mallrat ose shërbimet tek një klient për shumën të cilën njësi ekonomike pret të ketë të drejtën të arkëtojë. Në varësi të përmbushjes së disa kriterëve, e ardhura njihet:

— përgjatë periudhës, në një mënyrë që pasqyron ecurinë e njësisë ekonomike; ose

— në një moment kohor, kur kontrolli mbi mallrat ose shërbimet i transferohet klientit.

SNRF 15 gjithashtu vendos parimet që një njësi ekonomike duhet të zbatojë për dhënien e shënimeve shpjeguese cilësore dhe sasiore që japin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare mbi natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë në lidhje me të ardhurat si dhe mbi flukset monetare nga kontratat me klientët.

Megjithëse ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë, drejtimi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë. Koha dhe matja e të ardhurave të Shoqërisë nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Shoqërisë dhe llojit të të ardhurave që ajo realizon.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira, KIS-15 Qiratë Operative - Stimujt dhe KIS-27 Vlerësimi i Përmbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njihet një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative. Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 duke lejuar edhe zbatim më të hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Shoqëria ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave së Shoqërisë në atë datë, vlerësimin më të fundit të Shoqërisë nëse do të ushtrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Shoqëria do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime të reja për qiratë e saj operative të ambienteve të zyrave qendrore. Më 31 dhjetor 2017, pagesat e paskontuara minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të pa-anulueshme janë 4,314 mijë Lekë (shih Shënimin 27). Për më tepër, natyra e shpenzimeve që lidhen me ato qira do të ndryshojë tashmë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e njëtrajtshme të qirasë me shpenzimin e amortizimit të së drejtës së përdorimit të aktiveve me qira dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimet e qirasë.

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(r) Standarde dhe interpretime të reja që nuk janë ende efektive(vazhdim)

Standarde dhe interpretime të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- SNRF 9 Instrumentet Financiare
- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2)
- Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40)
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28)
- KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhëniet në Monedhë të Huaj
- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9)
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)
- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23)
- Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19).

4. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme

Një numër i politikave dhe paraqitjeve kontabël te Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës se drejte si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe ato jo financiarë. Vlerat e drejta është përcaktuar për qëllime të matjes dhe/ose paraqitjes, bazuar në metodat vijuese. Kur është e zbatueshme, informacion i mëtejshëm për supozimet e bëra, në përcaktimin e vlerave të drejta pasqyrohen në shënimet specifike për atë aktiv ose detyrim. Për më tepër, në shënimin 26 përshkruhen gjykimet e përdorura në njohjen e aktiveve dhe detyrimeve tatimore te shtyra.

(a) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Në vijim të ndryshimit të pronësisë të paraqitur në shënimin 1, Shoqëria ka përdorur çmimin e transaksionit për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve. Drejtimi konkludoi se aktivet nuk janë zhvlerësuar duke qenë se çmimi i transaksionit tejkalon vlerën e aktiveve.

Pavarësisht humbjeve të ndodhura gjatë viteve të para të veprimtarisë së Shoqërisë, ajo pret të rezultojë fitimprurëse dhe të gjenerojë flukse monetare pozitive në të ardhmen. Projektimet e flukseve monetare të ardhshme varen nga rishikimi dhe përfundimi i suksesshëm i produkteve të Shoqërisë dhe përshtatja e mëtejshme e tyre ndaj tregut lokal. Shoqëria po merr masa për të ulur kostot dhe të rezultojë fitimprurëse duke nisur nga viti 2019. Ajo është duke analizuar nevojat për të rishikuar planin e marketingut, ndërsa buxheti tashmë është rishikuar. Për më tepër, Shoqëria është në proces analizimi të nevojave për të përshtatur më tej produktet e saj ndaj tregut Shqiptar. Numri i pikave të shitjes pritet të rritet dhe lloje të reja biletash gërvishtëse si edhe produkte të reja do të prezantohen tek konsumatorët në të ardhmen e afërt. Produktet e reja që do prezantohen përfshijnë llotaritë elektronike që pritet të rrisin ndjeshëm të ardhurat.

Një ndryshim i Ligjit të Lojërave të Fatit, i miratuar më 22 dhjetor 2016, lejon organizatorët e kazinove elektronike dhe bingoje tradicionale që janë licencuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të ushtruar veprimtarinë e tyre vetëm në ambientet e hapura para ndryshimit të ligjit deri në 31 dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe kalimtare, hapja e objekteve të reja nuk lejohet. Drejtimi pret që bazuar në licencën e saj, Shoqëria të jetë operatori i vetëm që do të ushtrojë një aktivitet të tillë në treg pranë zonave të caktuara, pas 31 dhjetorit 2018, dhe kjo është përparësia kryesore konkurruese e Shoqërisë, e aplikueshme në periudhat e ardhshme.

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme (vazhdim)

(b) Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e llogaritve të arkëtueshme është vlerësuar të jetë e përafërt vlerën e mbartur në datën e raportimit duke pasur parasysh afatin e shkurtër të të arkëtueshmeve. Detaje të mëtejshme për vjetërsinë dhe zhvlerësimin e të arkëtueshmeve janë përshkruar në shënimin 5 (c).

(c) Aktivitet monetare dhe ekuivalentët

Aktivitet monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe llogarite rrjedhëse me bankat vendase. Meqenëse këto teprica janë afatshkurtër, vlera e tyre e drejtë e tregut është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e mbartur.

(d) Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuara

Vlera e drejtë e tregut, e cila përcaktohet për qëllime paraqitjeje, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të principalit dhe interesave, të skontuara me normën e interesat të tregut në datën e raportimit. Për huamarrjet, norma e interesit e tregut përcaktohet duke iu referuar marrëveshjeve të ngjashme dhe vlera e drejtë e huave është e përafërt me vlerën e mbartur.

(e) Provizionet

Shoqëria ka njohur provizione për çështjet gjyqësore, siç është detajuar në shënimin 15. Shoqëria i konsideron këto provizione si të përshtatshme, duke u bazuar në njohuritë e saj për natyrën e secilit provizion dhe rezultatin e pritur të çështjeve gjyqësore.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar nga rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i tregut
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i kredisë

Ky shënim përfaqëson informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe procedurat e matjes dhe menaxhimit të rrezikut dhe menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë. Shënime të tjera shpjeguese sasiore janë të përfshira përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballet, për të vendosur limite dhe kontrole, dhe monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin çdo punonjës kupton rolin dhe detyrimet përkatëse.

(a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rrjedhojë e ndryshimeve në çmimet e tregut, në kurset e këmbimit të valutës, në normat e interesit dhe në çmimet e kapitalit.

Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Shoqëria, në një moment të caktuar kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të pritshmërive të çmimeve të ardhshme apo lëvizjeve në normat e tregut, të përbërjes së aktiveve fizike të Shoqërisë dhe marrëveshjeve në të cilat Shoqëria është angazhuar. Drejtimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të jetë i pranueshëm, i cili monitorohet çdo muaj. Gjithsesi, kjo qasje nuk parandalon humbjet përtej këtyre limiteve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë kryhet në monedhat Lek dhe Euro. Rreziku i kursit të këmbimit krijohet kur transaksione të ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë. Duke qenë se huatë janë marrë në Euro, dhe aktiviteti kryhet në Lek, ekziston rreziku i mospërputhjes së monedhave të huaja. Meqë monedha raportuese është Leku, drejtimi vlerëson se rreziku i monedhës së huaj mund të përbëjë një problem për Shoqërinë. Drejtimi vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit për çdo monedhë dhe në total. Pozicionet monitorohen çdo muaj. Kurset e këmbimit të mëposhtme, janë aplikuar gjatë periudhës:

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(a) Rreziku i tregut (vazhdim)**(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)*

	Kursi mesatar		Kursi i këmbimit në datën e raportimit	
	2017	2016	2017	2016
Lek / EUR	134.15	137.37	132.95	135.23
Lek / USD	119.08	124.13	111.10	128.17
Lek / CAD	91.73	93.68	88.64	95.09

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 ëshë si më poshtë:

31 dhjetor 2017	Euro	Lek	Totali
Aktivët financiarë			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	124,424,820	7,205,833	131,630,653
Kërkesa të arkëtueshme	-	24,657,546	24,657,546
	124,424,820	31,863,379	156,288,199
Detyrimet financiarë			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	10,716,351	4,325,126	15,041,477
Detyrime të tjera	-	37,773,017	37,773,017
Detyrimet e lojrave	-	59,362,545	59,362,545
Hua	341,956	-	341,956
	11,058,307	101,460,688	112,518,995
Ekspozimi neto	113,366,513	(69,597,309)	43,769,204

31 dhjetor 2016	Euro	Lek	Totali
Aktivët financiarë			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	4,394,692	7,338,427	11,733,119
Kërkesa të arkëtueshme	-	20,770,527	20,770,527
	4,394,692	28,108,954	32,503,646
Detyrimet financiarë			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	4,237,710	9,283,384	13,521,094
Detyrime të tjera	-	49,221,697	49,221,697
Detyrimet e lojrave	-	48,750,416	48,750,416
Hua	998,265,621	-	998,265,621
	1,002,503,331	107,255,497	1,109,758,828
Ekspozimi neto	(998,108,639)	(79,146,543)	(1,077,255,182)

Duke menaxhuar rrezikun e kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në afatgjatë, megjithatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit të monedhës së huaj mund të kenë një ndikim në fitim. Një vlerësim ose zhvlerësim i Lekut, siç paraqitet më poshtë, mund të ketë ndikimet përkatëse në ulje ose rritje të kapitalit dhe të fitimit ose humbjes me shumat e paraqitura më poshtë. Kjo analizë bazohet në variancat prej 10% të kurseve të këmbimit të monedhave të huaja, që Shoqëria konsideron në mënyrë të arsyeshme të mundshme në fund të periudhës raportuese.

Në Lek	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Rritje	Rënie	Rritje	Rënie
EUR	11,336,651	(11,336,651)	(99,810,864)	99,810,864

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(a) Rreziku i tregut (vazhdim)**(ii) Rreziku i normës së interesit*

Rreziku kyresor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar janë rreziqet nga luhatja e flukseve të ardhshme monetare ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë për shkak të ndryshimit të normës së interesit të tregut (ndryshimi/hendeku mes vlerës aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit manaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të diferencave të normave të interesit. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt kufijve të ndryshimit të normës së interesit plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të normave të interesit. Skenarë standarde që konsiderohen në baza të rregullta përfshijnë 100 pikë baze rënie ose rritje paralele në të gjitha kurbat e normave të kthimit.

Shoqëria kishte një hua interes-bartëse me Bankën Raiffeisen Albania më 31 dhjetor 2016 (shih shënimin 13). Huaja kishte një normë interesi 5% plus Euribor 1 vjeçar, por jo më pak se 5.3% p.a dhe është shlyer plotësisht më 31 dhjetor 2017. Më 31 dhjetor 2017, huatë përfshijnë karta krediti biznesi, afatshkurtra të cilat përdoren për nevojat e kapitalit qarkullues me një normë interesi prej 14% p.a.

Një analizë e ndjeshmërisë së Shoqërisë ndaj rritjes apo rënies së normave të interesit në treg (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit në treg dhe një pozite konstante e pozicionit financiar) jepet si më poshtë:

<i>Në Lek</i>	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i vlerësuar i fitim/(humbjes)	(3,420)	3,420	(9,982,656)	9,982,656

(iii) Menaxhimi i kapitalit

Bazuar në legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të sigurohet licenca për “Lotari Kombëtare”, kapitali minimal i kërkuar është 1,200,000,000 Lek. Në fund të 31 dhjetorit 2017, kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 2,570,940,000 Lek. (31 dhjetorit 2016: 1,201,950,000 Lek). Pas rritjes së kapitalit në 2017 kapitali neto nuk është më negativ.

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve kur ato janë të pagueshme. Shoqëria është e ekspozuar çdo ditë ndaj kërkesës për burimet e saj monetare kryesisht për të shlyer shpenzimet operative që kryhen gjatë aktivitetit të zakonshëm të saj.

Qasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurohet, sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë gjithmonë likuiditetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e saj në afat, si në kushte normale dhe në ato të rënda, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e imazhit të Shoqërisë. Shoqëria pret të përmbushë detyrimet përmes flukseve të pritshme të parasë nga aktiviteti dhe me mbështetje nga mëma.

Detyrimet më të rëndësishme deri më 31 dhjetor 2017 paraqesin huatë nga bankat të cilat u ripaguan plotësisht pas kontributit të kapitalit nga mëma në 2017. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nëpërmjet kontributeve të mëmës.

Tabela e mëposhtme tregon flukset e aktualizuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë duke marrë për bazë maturitetin më të hershëm kontraktual ose flukset e pritshme.

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)*

31 dhjetor 2017	Deri ne 3 muaj	Nga 3 muaj deri ne 1 vit	Me shume se 1 vit	Totali
Detyrimet financiare				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	15,041,477	-	-	15,041,477
Detyrime të tjera	37,773,017	-	-	37,773,017
Detyrimet e lojrave	59,362,545	-	-	59,362,545
Hua	341,956	-	-	341,956
Totali i detyrimeve financiare	112,518,995	-	-	112,518,995

31 dhjetor 2016	Deri ne 3 muaj	Nga 3 muaj deri ne 1 vit	Me shume se 1 vit	Totali
Detyrimet financiare				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	13,521,094	-	-	13,521,094
Detyrime të tjera	49,221,697	-	-	49,221,697
Detyrimet e lojrave	48,750,416	-	-	48,750,416
Hua	7,651	-	998,257,970	998,265,621
Totali i detyrimeve financiare	111,500,858	-	998,257,970	1,109,758,828

(c) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij kontraktual që lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë dhe nga mjetet monetare të mbajtura tek Raiffeisen Bank Albania.

Rreziku potencial i kredisë në marrëdhëniet tregtare ekziston kryesisht me pikat e shitjes nën një marrëveshje bashkëpunimi, zbutet nga procedura specifike të përzgjedhjeje të pikave të shitjes, duke vendosur limite operative mbi vlerat e luajtura në terminalet e lojrave dhe prej kontrolleve ditore mbi ndryshimin e balancave debitorë, çka në rastet e mos pagesave, mund të rezultojë me bllokimin e terminalit ose revokimin e autorizimit për të vepruar si një pikë shitjeje e Lotarisë Kombëtare kur evidentohen raste të vazhdueshme të mos-pagesave.

Kërkesat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 sipas vjetërsisë janë detajuar si më poshtë:

	2017	%	2016	%
Më pak se 1 muaj	14,887,632	60.38%	17,363,906	83.60%
1 deri në 3 muaj	7,580,295	30.74%	2,849,453	13.72%
Mbi 3 muaj	2,189,619	8.88%	557,168	2.68%
Totali	24,657,546	100.00%	20,770,527	100.00%

Drejtimi pret të arkëtojë të gjithë të arkëtueshmet gjendje në fund të vitit. Të arkëtueshmet janë kryesisht detyrime nga partnerët kontraktualë.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale

	Pajisje te lojrave të fatit	Pajisje kompjuterike	Mjete transporti	Përmirësimi i objekteve me qira	Pajisje të tjera	Mobilje zyrash dhe pajisje	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2016	280,875,083	55,349,110	43,709,225	13,069,095	5,601,828	9,190,550	407,794,891
Shtesa	-	136,000	-	-	32,000	-	168,000
Nxjerrje nga përdorimi	-	(57,680)	-	-	-	-	(57,680)
Më 31 dhjetor 2016	280,875,083	55,427,430	43,709,225	13,069,095	5,633,828	9,190,550	407,905,211
Shtesa	112,339	411,777	-	893,232	393,124	2,078,300	3,888,772
Nxjerrje nga përdorimi	(1,783,848)	-	(1,942,108)	(12,302,186)	(33,000)	-	(16,061,142)
Më 31 dhjetor 2017	279,203,574	55,839,207	41,767,117	1,660,141	5,993,952	11,268,850	395,732,841
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 janar 2016	(69,977,958)	(30,593,009)	(24,670,220)	(7,354,375)	(1,957,986)	(4,427,071)	(138,980,619)
Shpenzimi për vitin	(29,620,127)	(7,346,481)	(8,759,711)	(2,614,747)	(1,129,201)	(1,811,602)	(51,281,869)
Nxjerrje nga përdorimi	-	19,227	-	-	-	-	19,227
Më 31 dhjetor 2016	(99,598,085)	(37,920,263)	(33,429,931)	(9,969,122)	(3,087,187)	(6,238,673)	(190,243,261)
Shpenzimi për vitin	(29,486,370)	(6,229,693)	(8,453,149)	(1,064,316)	(1,182,717)	(2,113,604)	(48,529,849)
Nxjerrje nga përdorimi	678,177	-	1,696,108	10,230,852	17,068	-	12,622,205
Më 31 dhjetor 2017	(128,406,278)	(44,149,956)	(40,186,972)	(802,586)	(4,252,836)	(8,352,277)	(226,150,905)
Vlera kontabël neto							
Më 1 janar 2016	210,897,125	24,756,101	19,039,005	5,714,720	3,643,842	4,763,479	268,814,272
Më 31 dhjetor 2016	181,276,998	17,507,167	10,279,294	3,099,973	2,546,641	2,951,877	217,661,950
Më 31 dhjetor 2017	150,797,296	11,689,251	1,580,145	857,555	1,741,116	2,916,573	169,581,936

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***7. Aktive afatgjata jo-materiale**

	Programe TI	Licensa	Totali
Më 1 janar 2016	30,782,688	500,000,000	530,782,688
Shtesa	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	30,782,688	500,000,000	530,782,688
Shtesa	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	30,782,688	500,000,000	530,782,688
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar 2016	(18,916,239)	(133,333,333)	(152,249,572)
Shpenzimi për vitin	(6,550,042)	(50,000,000)	(56,550,042)
Më 31 dhjetor 2016	(25,466,281)	(183,333,333)	(208,799,614)
Shpenzimi për vitin	(1,584,200)	(50,000,000)	(51,584,200)
Më 31 dhjetor 2017	(27,050,481)	(233,333,333)	(260,383,814)
Vlera kontabël neto			
Më 1 janar 2016	11,866,449	366,666,667	378,533,116
Më 31 dhjetor 2016	5,316,407	316,666,667	321,983,074
Më 31 dhjetor 2017	3,732,207	266,666,667	270,398,874

8. Inventarët

	2017	2016
Biletat gërvishtëse	59,042,151	56,056,175
Pjesë këmbimi	6,397,342	5,843,299
Skedat e lotarisë	4,409,694	4,966,447
Letër për bileta lotarie	959,894	1,086,260
Materialet e tjera	2,817,515	4,054,580
Zhvlerësim i inventarit	(21,601,178)	-
Totali	52,025,418	72,006,761

Zhvlerësimi i inventarit lidhet me disa bileta gërvishtëse që kanë qenë me performancë të ulët në treg. Shuma është një vlerësim për bileta gërvishtëse që nuk përmbushin pritshmëritë dhe do të nxirren jashtë inventarit pas përfundimit të procedurave ligjore dhe vendimeve përfundimtare të drejtimit. Kjo shumë e provizionuar i referohet gjendjes së inventarit më 31 dhjetor 2017.

9. Kërkesa të arkëtueshme

	2017	2016
Kërkesa të arkëtueshme	24,657,546	20,770,527
Totali	24,657,546	20,770,527

Kërkesat e arkëtueshme përfaqësojnë një borxh afatshkurtër të pambledhur nga partnerët kontraktualë më 31 dhjetor 2017 për shitjen e produkteve të lotarisë. Bazuar në marrëveshjen kontraktuale, shuma e pashlyer paraqitet neto nga çmimet e paguara dhe komisionet bonus.

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***10. Aktive të tjera**

	2017	2016
Shpenzime të shtyra	3,305,064	4,071,883
Shpenzime të parapaguara qiraje	1,785,923	2,556,464
Mjete monetare të bllokuara	5,636,665	7,159,588
Paradhënie ndaj punonjësve	87,710	1,111,154
Të arkëtueshme nga autoritetet tatimore	15,487,998	-
Totali	26,303,360	14,899,089

Shpenzimet e parapaguara të qirasë përfaqësojnë shuma të paguara palëve të treta si garanci për ambjentet e marra me qira nga Shoqëria për përdorim si zyra qendrore dhe apartamente për përdorim nga punonjësit. Shpenzimet e shtyra përfaqësojnë parapagimet për primet e sigurimit të automjeteve, shpenzimet e parapaguara për mirëmbajtjen e programit kompjuterik dhe shpenzime për shërbimet e internetit.

Mjetet monetare të bllokuara përfaqësojnë kolateralin e vendosur për karta krediti prej 2,036,665 Lek (2016: 2,059,588 Lek) dhe vlera të bllokuara për humbjet e mundshme nga çështjet gjyqësore aktuale me Bashkinë në Durrës në shumën prej 3,600,000 Lek (2016: 5,100,000 Lek). Shoqëria ka krijuar provizione për taksat lokale (shënimi 15) në lidhje me këto çështje gjyqësore.

11. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	2017	2016
<i>Mjete monetare në arkë</i>		
Në Lek	1,689,206	1,062,321
Në Euro	8,858	78,938
	1,698,064	1,141,259
<i>Llogari rrjedhëse</i>		
Në Lek	5,445,880	5,424,711
Në Euro	124,372,186	4,271,228
	129,818,066	9,695,939
<i>Depozita afat shkurtër</i>		
Në Lek	70,748	851,395
Në Euro	43,775	44,526
	114,523	895,921
TOTALI	131,630,653	11,733,119

12. Kapitali aksionar

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 2,570,940,000 Lek (31 dhjetor 2016: 1,201,950,000 Lek), dhe përbëhet nga 257,094 aksione të zakonshme (2016: 120,195) me vlerë nominale 10,000 Lek për çdo aksion. Struktura aksionare me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si vijon:

	2017		2016	
	Totali ne Lek	Në %	Totali ne Lek	Në %
Albanisch Osterreichische Lotterien Holding Gesellschaft	2,570,940,000	100	1,201,950,000	100

13. Huatë

	2017	2016
Pjesa afatshkurtër e huasë (shënimi 5.a(ii))	341,956	7,651
Pjesa afatgjatë e huasë	-	998,257,970
Totali	341,956	998,265,621

Në gusht 2015, Shoqëria u rifinancua nga Raiffeisen Bank Albania, për një shumë totale prej 7.5 milionë Euro (ekuivalente me 1,014 milion Lek) që mbarojnë më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2016, kishte përfituar disbursime në shumën totale prej 998,265,621 Lek. Huaja kishte një normë interesi prej 5% plus një Euribor 1-vjeçar, por jo më pak se 5.3% p.a. Huaja u pagua plotësisht në vitin 2017.

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***14. Të pagueshme ndaj furnitorëve**

	2017	2016
Furnitorët vendas	14,699,869	13,032,756
Furnitorët e huaj	122,784	185,314
Palë të lidhura	218,824	303,024
Totali	15,041,477	13,521,094

15. Detyrime të tjera

	2017	2016
Taksa të pagueshme	20,895,928	39,058,906
Shpenzime të përlllogaritura	2,257,236	3,277,628
Detyrime për sigurimet shoqërore	1,152,864	1,022,382
Të ardhura të shtyra	22,400	1,282,200
Provizione të tjera	11,643,760	2,656,000
Detyrime ndaj personelit	44,691	96,232
Detyrime të tjera	1,756,138	1,828,349
Totali	37,773,017	49,221,697

Shpenzimet e përlllogaritura përfshijnë komunikim telefonik, auditimin, konsulencën dhe shpenzimet e tjera të përlllogaritura të ndodhura gjatë vitit, për të cilat faturat janë marrë pas datës së raportimit.

Tatimet e pagueshme janë si më poshtë:

	2017	2016
Detyrime tatimore të lojrave të fatit	9,737,383	9,755,502
Taksa lokale	5,299,038	4,859,657
Tatim mbi të ardhurat personale	2,812,201	2,265,371
Tatim në burim	2,432,660	1,105,372
Provizione për penalitete tatimore	520,000	3,033,462
TVSH e pagueshme	94,646	40,107
Detyrime tatimore të rivlerësuar	-	17,999,435
Totali	20,895,928	39,058,906

Gjatë vitit 2014, Shoqëria ka qenë subjekt i një kontrolli tatimor nga Autoritetet Tatimore Shqiptare që ka patur si subjekt vitet financiare 2012 dhe 2013. Bazuar në raportin final të kontrollit tatimor të lëshuar më 12 shkurt 2014, detyrimet tatimore shtesë, duke përfshirë gjobat tatimore si rezultat i këtij kontrolli arrijnë në vlerën 61,307,584 Lek. Pas apelimit të parë në Drejtorinë e Apelit Tatimor detyrimet prej 28,860,000 Lek lidhur me TVSH janë hequr. Shoqëria ka paguar shumën prej 15,480,147 Lek për detyrimet tatimore të ngarkuara dhe për gjobat e lidhura me to, dhe ka apeluar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, vendimi i së cilës ka dalë në favor të Shoqërisë duke hequr pjesën e mbetur të detyrimeve. Ky vendim është apeluar dhe Shoqëria e ka fituar çështjen sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit të datës 14 nëntor 2017.

Detyrimet tatimore të vlerësuar të Shoqërisë janë zero më 31 dhjetor 2017 (2016: 17,999,435 Lek, ku përfshihen 16,967,437 Lek për tatimin mbi të ardhurat dhe gjobat, dhe interesin e pagueshëm prej 1,031,998 Lek).

Lëvizjet për çështjet e tjera gjyqësore me punonjësit janë si më poshtë:

	2017	2016
Gjendja më 1 janar	2,656,000	544,544
Provizione të regjistruara gjatë vitit (shënimi 23)	8,987,760	2,344,000
Provizione të përdorura gjatë vitit	-	(232,544)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	11,643,760	2,656,000

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***16. Detyrimet e lojrave**

Detyrimet e lojrave të fatit përfaqësojnë detyrime për çmimet fituese të “Lotos 6 nga 39”, të biletave gërvishtëse dhe të Keno.

	2017	2016
Detyrimet e lojrave Lotto 6/39	30,208,108	20,913,809
Detyrimet e lojrave bileta gërvishtëse	29,122,772	27,836,609
Detyrimet e lojrave Keno	31,665	-
Total	59,362,545	48,750,418

17. Të ardhura nga lotaritë

	2017	2016
Të ardhura – Biletat gërvishtëse	179,695,600	184,882,700
Të ardhura – Loto 6 nga 39	50,479,600	45,345,100
Të ardhura – Keno	19,173,855	41,839,305
Totali	249,349,055	272,067,105

18. Shpenzime marketingu

	2017	2016
Shpenzime për mediat	61,269,886	30,447,822
Sponsorizime	33,180,172	6,298,753
Shpenzime për reklama dhe promocione	3,400,000	3,860,347
Tarifa për agjentët	280,133	2,400,000
Totali	98,130,191	43,006,922

19. Shpenzime për çmimet e lotarisë

	2017	2016
Fondi i çmimeve për biletat gërvishtëse	101,691,688	101,939,098
Fondi i çmimeve për loton 6 nga 39	25,818,212	22,963,713
Fondi i çmimeve për Keno	14,674,191	32,673,415
Totali	142,184,091	157,576,226

20. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen nga sa më poshtë:

	2017	2016
Shpenzime page	102,063,396	81,881,350
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,167,713	7,217,796
Bonuse dhe shpërblime të tjera	21,000	42,000
Totali	110,252,109	89,141,146

Shoqëria kishte 52 punonjës më 31 dhjetor 2017 (2016: 49), duke përfshirë 2 punonjës të huaj.

21. Taksat dhe tarifat e lojrave

	2017	2016
Tatimi për lojrat e fatit	24,808,925	27,312,767
Tarifë kontributi për çështjet e mira	5,457,964	6,013,088
Tarifa administrimi ndaj ‘Njesia mbikqyese e lojrave te fatit’	2,000,000	2,000,000
Totali	32,266,889	35,325,855

Bazuar në marrëveshjen e koncesionit, Shoqëria transferon kontributin prej 2.2% tek Ministria e Financës, si kontribut për çështje të mira.

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***22. Komisione ndaj agentëve**

Lotaria Kombëtare operon me shumë partnerë kontraktualë, të cilët tregtojnë produktet e Shoqërisë në gjithë territorin e Shqipërisë. Partnerët kontraktualë janë krijuar në mënyrë të pavarur nga Shoqëria, si subjekte të regjistruara ose persona fizike dhe përfitojnë nga komisionet e shitjeve në varësi të volumit të shitjeve. Për vitin 2017 dhe 2016 komisionet ndaj agentëve janë si më poshtë:

	2017	2016
Komisione ndaj agentëve – Bileta gërvishtëse	17,309,844	18,869,869
Komisione ndaj agentëve - Lotto	5,027,368	4,961,367
Komisione ndaj agentëve - Keno	1,791,617	3,785,942
Totali	24,128,829	27,617,178

23. Kosto e materialeve të përdorura

	2017	2016
Kosto e biletave gërvishtëse	9,421,523	7,579,987
Kosto e skedave të lotarisë	614,611	350,976
Kosto letrës së biletave të lotarisë	928,649	844,135
Totali	10,964,783	8,775,098

24. Shpenzimet e tjera operative

Shpenzimet e tjera operative përbëhen nga sa më poshtë:

	2017	2016
Zhvlerësimi i inventarit (shënimi 8)	21,601,178	-
Shpenzime qiraje	16,991,880	16,113,640
Provizione për raste gjyqësore (shënimi 15)	8,987,760	2,344,000
Materiale dhe furnizime	7,147,030	2,480,767
Shpenzime telekomunikimi dhe postare	6,265,807	6,376,990
Shpenzime IT	5,913,012	2,983,857
Mirëmbajtje dhe riparime	5,328,575	5,738,617
Shpenzime këshillimi	3,930,979	2,926,652
Shpenzime udhëtimi	3,413,513	638,220
Shpenzime karburanti	3,346,210	3,025,849
Shpenzime përfaqësimi	3,133,011	247,131
Humbja nga nxjerrja nga përdorimi i pajisjeve	2,650,720	38,453
Sigurime	1,742,744	2,137,569
Gjoha për tatime	1,546,502	-
Shpenzime komunale	1,305,537	1,067,195
Taksa të tjera nga tatim fitimi	1,167,980	5,614,474
Shpenzime sigurie	672,000	1,612,800
Tarifa për ofrimin e shërbimit Keno	575,428	1,252,622
Trajnime	159,109	196,095
Shpenzime rekrutimi	-	295,065
Shpenzime të tjera	5,795,422	2,811,326
Totali	101,674,397	57,901,322

Tarifa për ofrimin e shërbimit Keno përfaqëson mirëmbajtjen dhe shërbimet mbështetëse të ofruesit të sistemit Keno, i cili garanton mbarëvajtjen normale të aktivitetit të lojës, gjithashtu dhe kërkesat e raportimit.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

25. Të ardhura dhe shpenzime financiare, neto

	2017	2016
<i>Të ardhura financiare</i>		
Të ardhurat nga interesi mbi depozitat bankare	10,319	12,556
Fitimi neto nga diferencat e konvertimit	-	14,469,718
Të ardhura të tjera financiare	1,446	-
Total i të ardhurave financiare	11,765	14,482,274
<i>Shpenzimet financiare</i>		
Humbja neto nga diferencat e konvertimit	(20,680,722)	-
Shpenzimet e interesit	(4,357,297)	(51,409,220)
Shpenzime të tjera financiare	(1,750)	(317,588)
Total i shpenzimeve financiare	(25,039,769)	(51,726,808)
Shpenzime neto financiare	(25,028,004)	(37,244,534)

26. Tatimi mbi fitimin

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatimi i njohur ne fitim ose humbje përbëhet nga sa më poshtë:

	2017	2016
Shpenzimi i tatim-fitimit	-	-
Shpenzimi tatimor i shtyrë	363,882	3,634,228
Totali	363,882	3,634,228

	%	2017	%	2016
Rakordimi i tatim fitimit efektiv				
Humbja për vitin		(356,206,900)		(263,859,165)
Tatim fitimi me normën e aplikueshme	15	(53,431,035)	15	(39,578,875)
Shpenzimet e panjohura	(3)	9,953,936	(5)	12,392,426
Humbjet e panjohura tatimore	(14)	51,577,805	(11)	29,421,961
Diferenca të perkohshme të panjohura	2	(7,736,824)	(0.5)	1,398,716
Totali	(0.10)	363,882	(1.38)	3,634,228

Humbjet fiskale të viteve 2014, 2015 dhe 2016 nuk janë mbartur pasi humbjet fiskale nuk mund të mbarten pas ndryshimeve në strukturën e pronësisë për më shumë se 50% (shiko shënimin 1).

Shoqëria nuk ka njohur aktive tatimore të shtyra në lidhje me humbjet e akumuluarat tatimore prej 51,577,805 Lek, edhe pse është e mundur që Shoqëria të rezultojë me fitim në të ardhmen. Drejtimi pret që Shoqëria të gjenerojë fitime në të ardhmen dhe duke filluar nga periudha kur do të raportohen fitimet, ajo mund të fillojë të njohë aktivet tatimore të shtyra në atë masë që realizimi i përfitimit tatimor të lidhur është i mundshëm.

Tatim fitimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën e miratuar tatimore 15% (2016: 15%). Aktivi dhe detyrim i tatimor i shtyrë i njohur u atribuohet zërave të mëposhtëm:

Të njohur	Aktivi		Detyrimi		Neto	
	2017	2016	2017	2016	2017	2016
Aktive afatgjata materiale	-	-	4,419,762	4,279,496	(4,419,761)	(4,279,496)
Shpenzime të nisjes	2,898,305	3,450,363	-	-	2,898,305	3,450,363
Aktive afatgjata jomateriale	-	-	10,099,394	10,427,835	(10,099,394)	(10,427,835)
	2,898,305	3,450,363	14,519,156	14,707,331	(11,620,850)	(11,256,968)

Lotaria Kombëtare sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

27. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara

Ligjore

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ka qenë e përfshirë në disa pretendime ligjore dhe gjyqësore me konkurentë, punonjës dhe administratën shtetërore për të cilat provizionet e lidhura me to janë njohur sipas nevojës.

Angazhimet për qira operative

Shoqëria nuk ka asnjë marrëveshje qiraje operative të paanulueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje qiraje për ambientet e zyrave të veta dhe për apartamente të cilat janë të anulueshme me njoftim paraprak sipas kushteve kontraktuale. Kontratat e qirasë operative janë të anulueshme, me një periudhë maksimale njoftimi prej 90 ditësh. Angazhimet maksimale të paanulueshme të qirasë më 31 dhjetor 2017 janë 4,314 mijë Lek (2016: 2,396 mijë Lek).

Garanci te vëna për Shoqërinë

Një garanci në shumën e 20,000,000 Lek është dhënë ndaj Ministrisë së Financave, Qeveria Shqiptare, siç kërkohet nga kushtet e marrëveshjes së licencës, e cila është siguruar nga Novomatic Gaming Industries GmbH (shiko shënimin 1).

28. Palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura që përfaqësojnë transaksione me Shoqërinë mëmë, Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H., njësitë nën kontrollin e Novomatic Gaming Industries GmbH, ('filiale') (shiko shënimin 1) dhe drejtuesit kryesorë, janë detajuar më poshtë:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
<i>Të ardhura</i>		
Shërbime midis filialeve (2016: me Mëmën)	168,850	25,641,252
<i>Shpenzime me filiale</i>		
Qira	746,501	-
Shërbime konsulence	197,921	-
Komisione	125,759	-
Garanci bankare	-	308,710
<i>Të pagueshme</i>		
Filiale	218,824	-
Shoqëria Mëmë	-	308,710

Totali i kompensimit të paguar për drejtuesit kryesorë të Shoqërisë gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 33,727,606 Lek (2016: 22,538,913 Lek). Një pjesë e këtyre kostove i janë alokuar dhe ngarkuar Mëmës gjatë vitit 2016.

Garancitë e vëna nga palët e lidhura janë detajuar në shënimin 27.

29. Ngjarjet pas datës së raportimit

Në janar 2018, Shoqëria ka zhbllokuar një pjesë të fondeve të ngurtësuara në shumën prej 3,600,000 Lek (shiko shënimin 10) pas përfundimit të procesit gjyqësor me Bashkinë e Durrësit.

Për shkak të ndryshimeve në ligjin për lojrat e fatit, efektiv që nga janari 2018, taksat dhe tarifat e lojrave do të llogariten mbi Marzhin Bruto të Lojës që është diferenca midis xhiros totale dhe pagesave të çmimeve fituese. Drejtimi pret një ndikim pozitiv mbi flukset monetare të ardhshme dhe rezultatet neto të Shoqërisë, që do të rezultojnë nga ndryshimi i tillë.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat kërkohet rregullim apo shënim në këto pasqyra financiare.